

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl-Kzz 71/09

10 nëntor 2009

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, me Gjyqtarin kosovar Miftar Jasiqi si Gjyqtar raportues dhe Gjyqtarët kosovarë Osman Tmava, Zait Xhemajli dhe Agim Krasniqi si anëtarë të kolegjit, dhe në prani të Këshilltares ligjore Edita Kusari dhe Mejreme Memaj si prosecmbajtëse, në lëndën penale Pkl-Kzz. nr. 71/09 të Gjykatës Supreme të Kosovës

kundër të pandehurit **Florim Ejupi**, nofka Luli, i biri i Mursel Ejupit dhe Fatime Berishës, i lindur më 15 qershor 1978, në Gllavnik, komuna e Podujevës, shqiptar kosovar, me adresë të përhershme banimi të fundit në fshatin Sekiraçë, komuna Podujevë, Kosovë, i martuar, baba i dy fëmijëve të moshës 8 dhe 7 vjeç, me tetë klasë të kryera të shkollës fillore, me profesion bujk, me një gjendje të mesme ekonomike, i padënuar më herët, i mbajtur në paraburgim në mes të datës 19 mars dhe 14 maj 2001, dhe në burgim të pandërprerë që nga data 8 qershor 2004;

I dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Prishtinë, të datës 06 qershor 2008, P. Nr. 202/2005 për kryerjen e veprave penale:

Vrasje, në kundërshtim me nenin 30, paragrafët (1), (2), nën-paragrafët 1, 2, 3 (duke përjashtuar hakmarrjen e pamëshirshme dhe përfitim personal) dhe 5 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), ligje këto të zbatueshme me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), (ekuivalente me Vrasje në shkelje të nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK)) dhe Vrasje të rëndë në shkelje të nenit 147 të KPPK-së;

Vrasje në tentativë, në kundërshtim me nenin 30, paragrafët (1), (2) nën par. 1, 2,3 (përjashtuar hakmarrjen e pamëshirshme dhe përfitim personal) dhe (5) të LPK-së, në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KP-së së RSFJ-së (ekuivalente me Vrasje të rëndë në tentativë në shkelje të nenit 146 dhe 147, pikat 1, 3, 9 dhe 11 të KPPK-së, në lidhje me nenin 20 të KPPK-së;

Terrorizëm, në kundërshtim me nenin 125 të KP së RSFJ-së, në lidhje me nenin 22 të KP së RSFJ-së (ekuivalent me nenin 110 të KPPK-së, në lidhje me nenin 109 dhe nenin 23 të KPPK-së);

Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, në kundërshtim me nenin 157, paragrafët (1) dhe (3) dhe nenin 164 paragrafin 1 të LPK-së, në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së (ekuivalent me nenin 291 të KPPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPPK-së);

Diskriminim racor dhe tjetër, në kundërshtim me nenin 154 të KP të RSFJ-së, në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së;

Mbajtje e paligjshme e substancave shpërthyes, në kundërshtim me nenin 199, paragrafët (1) dhe (3) të LPK-së; (ekuivalent me nenin 328 të KPPK-së, në lidhje me nenin 291 të KPPK-së);



Dhe i dënuar me dënim të integruar prej dyzet (40) vjet burgim, duke llogaritur në të kohën e kaluar në paraburgim prej datës 19 mars deri më 14 maj 2001, dhe në vuajtje të pandërprerë të burgimit prej datës 8 qershor 2004, duke pritur datën kur aktgjykimi të merr formën e prerë;

I liruar nga të gjitha akuzat në shkallën e dytë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.-Kz. Nr. 409/2008, të datës 12 mars 2009, sipas nenit 426 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK),

Duke vepruar sipas Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë të paraqitur nga ana e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSK), të datës 28 maj 2009, drejtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 12 mars 2009 (Ap.-Kz. Nr. 409/2008),

Lëshon këtë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë e ZPPK-së e datës 28 maj 2009 kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap.-Kz. Nr. 409/2008) e datës 12 mars 2009

refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

I. Historia e Procedurës

(1) Më 16 shkurt 2001 afër fshatit Livadice, Komuna e Podujevës një grup i kryerësve të krimit vendosën një mjet shpërthyes, që ishte vendosur për atë qëllim në një kanal përgjatë rrugës së një karvani me autobusë që bartte udhëtarë të etnisë serbe nga Nishi i Serbisë deri në Graçanicë të Kosovës. Rreth orës 11.15 autobusi i parë i karvanit që bartte 57 udhëtarë u godit nga një shpërthim masiv që ngriti autobusin nga toka, shkatërroi pjesën e parme të tij dhe menjëherë vrau shoferin dhe të gjithë udhëtarët e ulur në atë pjesë. Udhëtarët tjerë ishin lënduar rëndë, disa prej tyre vdiqën më vonë, gjatë marrjes së ndihmës mjekësore. Ky akt i dhunshëm krijoi një ndjenjë të pasigurisë personale për qytetarët e etnisë serbe në Kosovë. Veç kësaj, ky akt doli të jetë përgjithësisht i rrezikshëm, pra duke rrezikuar jetë e trup njeriu në vend ku zakonisht mblidhet një numër i madh i njerëzve dhe udhëton dhe *de facto* rezultoi me vdekjen e 11 personave dhe me lëndimin e rëndë trupor të 10 personave tjerë. Në



bazë të etnisë së tyre serbe, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të palës së dëmtuar të njohura nga bashkësia ndërkombëtare janë shkelur.

(2) Më 23 mars 2001, i pandehuri Florim Ejupi dhe tre të dyshuar tjerë pas arrestimit të tyre ishin paraburgosur duke u bazuar në një urdhër për paraburgim nga Gjyqtari hetues i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (Hep. Nr. 47/2001). Pas ankesës së Avokatit mbrojtës, kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i përbërë prej Gjyqtarja ndërkombëtare Renate Winter si Kryetare e kolegjit dhe Gjyqtarët ndërkombëtarë Guy Van Craen dhe Jose Manuel Rodriguez si anëtarë të kolegjit konstatuan se ankesa ishte e bazuar sa i përket tre të dyshuarve tjerë, por jo edhe sa i përket të pandehurit Florim Ejupi. Kolegji konstatoi se bazuar në dëshmitë të siguruar nga shkresat e lëndës dyshimi i bazuar siç kërkohet me ligj për paraburgim “... ekziston (vetëm) në rastin e Florim Ejupit pasi që analiza e ADN-së në gjurmët e gjetura në cigaren e konsumuar, e cila ishte siguruar në vendin ku ishte aktivizuar bomba, tregoi një mostër të ADN-së që korrespondon me një mostër të marrë më herët nga ana e KFOR-it Gjerman nga Florim Ejupi, i cili kishte qenë i akuzuar për grabitje të rëndë, vrasje në tentativë dhe krime tjera.”.

(3) Më 17 maj 2006 dhe duke u bazuar në rezultatet e hetimeve të policisë dhe prokurorisë Prokurori publik ndërkombëtar paraqiti një aktakuzë kundër të pandehurit Florim Ejupi, dhe si rrjedhim pretendon bashkëkryerjen e tij me të tjerët në kryerjen e veprave penale të lartpërmendura, duke i cilësuar ato siç vijon:

- **Vrasje**, në kundërshtim me nenin 30, par. 1, 2, nën-paragrafët 1, 2, 3 (duke përjashtuar hakmarrjen e pamëshirshme dhe përfitimin personal) dhe 5 të LPK-së, ligje këto të zbatueshme me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, në lidhje me nenin 22 të KP i RSFJ-së, të 12 palëve të dëmtuara që pretendohet të kenë vdekur gjatë shpërthimit;
- **Lëndim të rëndë trupor**, në kundërshtim me nenin 38 par. 1 dhe 2 të LPK-së, në lidhje me nenin 22 të KP i RSFJ-së;
- **Ndërprerje të paligjshme të shtatzënisë**, në kundërshtim me nenin 37 par. 1 dhe 4 të LPK-së, në lidhje me nenin 22 të KP i RSFJ-së, duke shkaktuar vdekjen e fetusit që s’ka lindur ende të një viktime të vvarë;
- **Terrorizëm**, në kundërshtim me nenin 125 të KP i RSFJ-së, në lidhje me nenin 22 të KP i RSFJ-së;
- **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm**, në kundërshtim me nenin 157, paragrafët (1) dhe (3) dhe nenin 164 paragrafin 1 të LPK-së, në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së;
- **Diskriminim racor dhe tjetër**, në kundërshtim me nenin 154 të KP të RSFJ-së, në lidhje me nenin 22 të KP të RSFJ-së;
- **Mbajtje e paligjshme e substancave shpërthyesë**, në kundërshtim me nenin 199, paragrafët (1) dhe (3) të LPK-së.



(4) Më 27 prill 2007 është mbajtur shqyrtimi për konfirmim të aktakuzës sipas nenit 314 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) dhe aktakuza– duke marrë parasysh listën e azhurnuar të viktimave të vrara dhe të lënduara – u konfirmua me përjashtim të hakmarrjes së pamëshirshme dhe përfitimit personal (neni 30 par. 2, nën-par. 3 i LPK-së) në rastin e akuzave të Vrasjes. Veç kësaj, akuzat e Ndërprerjes së paligjshme të shtatzënisë ishte përjashtuar. Aktvendimi i konfirmimit ishte lëshuar më 25 qershor 2007 dhe u bë i formës së prerë më 15 gusht 2007.

(5) Duke u bazuar në të gjeturat e Gjyqtarit të konfirmimit, Prokurori publik ndërkombëtar paraqiti Aktakuzën e ndryshuar të datës 25 shtator, 02 dhe 18 tetor si dhe 26 dhjetor 2007.

(6) Më 06 qershor 2008 në shkallën e parë Gjykata e Qarkut në Prishtinë në aktgjykimin e vet (P. Nr. 202/2005) pasi kishte mbajtur shtatë seanca të shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësuar të gjitha dëshmitë e paraqitura në Gjykatë shpalli Florim Ejupin fajtor për veprat penale të lartpërmendura dhe e dënoi atë me një dënim të unifikuar me dyzet (40) vjet burgim, duke llogaritur në të kohën e kaluar në paraburgim prej datës 19 mars deri më 14 maj 2001, dhe në vuajtje të pandërprerë të burgimit prej datës 8 qershor 2004, duke pritur datën kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

(7) Më 04 shtator 2008 Avokati mbrojtës, në dobi të pandehurit Florim Ejupi, paraqiti ankesë kundër aktgjyimit të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 06 qershor 2008 (P. Nr. 202/2005), e cila ishte plotësuar më 10 tetor 2008.

(8) Më 12 mars 2008 pas mbajtjes së seancës, Gjykata Supreme e Kosovës shpalli një aktgjykim, duke pranuar ankesën e Avokatit mbrojtës dhe shpallur të pandehurin të pafajshëm. Si rezultat i kësaj. I pandehuri Florim Ejupi u lirua nga të gjitha akuzat.


(9) **Datuar më 28 maj 2009, ZPSK paraqiti një Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjyimit të përmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila është regjistruar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 29.05.09.**

Çështjet ankimore të ngritura në Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të ZSPK-së:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga ZSPK-ja pretendon shkelje themelore të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 451 par. 1 nën-par. 2 dhe 3 të KPPPK-së / tani Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Ajo pretendon:

1. shkelje të nenit 403 par. 1 nën-par. 1 në lidhje me nenin 40 par. 1 nën-par. 5 të KPPPK/KPPK-së. Sipas mendimit të ZPSK-së, Kryetari i kolegjit të Gjykatës Supreme, që duhej të vendoste mbi ankesën e Avokatit mbrojtës të datës 04 shtator 2008, Gjyqtari Guy Van Craen ishte shkualifikuar dhe me ligj ishte




përrjashtuar nga pjesëmarrja në kolegjin e shkallës së dytë, pasi që ai kishte qenë anëtar i kolegjit të Gjyqtarëve ndërkombëtarë të cilët vendosën si një kolegji prej tre-gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 28 mars 2001 mbi ankesën e të pandehurit Florim Ejupi kundër vendimit të Gjyqtarit hetues që cakton paraburgimin e tij. ZSPK-ja i referohet nenit 40 par. 1 pikës 5 të KPPPK/KPPK sipas të cilit *“një gjyqtar ... duhet të përjashtohet nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore në një lëndë të caktuar ... nëse në të njëjtën lëndë ai apo ajo ka marrë pjesë në lëshimin e vendimit të shkallës së të ulët ...”*. Një interpretim gramatikor i kësaj dispozite do të tregonte se pjesa e fundit e saj nuk është kusht shtesë por një alternativë e pavarur për përjashtimin e një gjyqtari.

- shkelje të nenit 403 par. 2 nën-par. 1 në lidhje me nenin 157 par. 3 të KPPPK/KPPK-së. Ky aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës do të bazohet në interpretimin e gabuar të dispozitave të procedurës penale që ndikojnë në ligjshmërinë e vendimit si të tillë. Në shkallën e parë, Prokurori publik kishte paraqitur një “dëshmitar Alfa” si dëshmi shtesë, deklarata e të cilit në shkallën e dytë ishte konsideruar nga Gjykata Supreme e Kosovës si deklaratë e një dëshmitari anonim sipas nenit 157 të KPPPK/KPPK-së. Për këtë shkak, kolegji i shkallës së dytë gabimisht nuk i kishte dhënë deklaratës së tij një peshë vendimtare, duke konsideruar se *“... në asnjë lëndë një aktgjykim nuk mund të bazohet, vetëm, në deklaratat e një dëshmitari anonim (neni 157 KPPPK/KPPK)”*. ZPSK -ja nënvizon se “dëshmitari Alfa” nuk ishte anonim por vetëm dëshmitar i mbrojtur bazuar në nenin 170 par. 1 pika 4 e KPPPK/KPPK-së.

Si konstatim ZSPK-ja kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës të miratojë Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar-mirë dhe të vërtetojë aktgjykimin e përmendur të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës sa i përket përmbajtjes së shkeljeve themelore të lartpërmendura të dispozitave të procedurës penale.

(10) Avokati mbrojtës paraqiti një përgjigje ndaj kërkesës së ZPSK-së për mbrojtje të ligjshmërisë, që ishte regjistruar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 24.06.09. Avokati mbrojtës konteston kundërshtimin e ZPSK-së siç është shënuar në Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke nxjerrë në pah se:

- Neni 40 par. 1 pika 5 e KPPK-së gjen ekuivalentin e vet në nenin 39 par. 1 pikën 6 të KPP (RSFJ)-së, që ishte e zbatueshme gjatë fazës së procedurës paraprake të kësaj lënde. Duke iu referuar komentit të B. Petriq mbi këtë çështje, mbrojtja është e mendimit se shkualifikimi i një gjyqtari është i mundur vetëm në rast se i njëjti gjyqtar ka vepruar si gjyqtar hetues apo si kryetar i trupit gjykues i kolegjit të shkallës së parë si dhe i kolegjit për ankesa, e që në këtë lëndë nuk rastisë të jetë ashtu.
- Neni 157 i KPPK-së nuk do të shkelet sa i përket “dëshmitarit Alfa”, pasi që neni 170 i KPPK-së i jep të drejtë gjyqtarit dhe kolegjit të gjykatës të caktojë çdo lloj mase mbrojtëse, që parashihen me ligj.



Prandaj mbrojtja kërkon të refuzohet Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si e pabazuar.

(11) Pasi Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it (KGjE) lëshoi një vendim më 11 qershor 2009, që u regjistrua në Gjykatën Supreme të Kosovës më 12 qershor 2009, duke caktuar një kolegji tërësisht vendor në këtë lëndë për shkak të gjendjes me personelin në Gjykatën Supreme, vendimi u ndryshua në pajtim me nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve (LmK) dhe nenin 26 të KPPK-së dhe u caktua një gjyqtar ndërkombëtar si kryetari kolegjit me vendim të KGjE-së të datës 09 nëntor 2009.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Pavarësisht nga fakti se në pajtueshmëri me nenin 457 par. 2 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës nuk duhet të ndërhyjë në vendimin përfundimtar të kolegjit të shkallës së dytë edhe nëse Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, pra e paraqitur në dëm të të pandehurit, është e bazuar mirë, Gjykata Supreme konstaton siç vijon:

1. Lejueshmëria e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e lejueshme. Është paraqitur në gjykatën kompetente sipas nenit 453 të KPPK-së dhe brenda afatit të nenit 452 par. 3 të KPPK-së.

2. Procedurat e ndjekura nga Gjykata Supreme

Kolegji i Gjykatës Supreme në seancë ka vendosur siç përcaktohen në nenin 454 par. 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar për seancën, pasi që sipas nenit 451 deri 460 të KPPK-së Gjykata Supreme nuk e ka obligim ti njoftojë palët.

3. Mbi meritat e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

a. Shkeljet e pretenduara të nenit. 403 par. 1 nën-par. 1 në lidhje me nenin 40 të KPPK-së

Nuk ka shkelje të nenit 403 par. 1 nën-par. 1 në lidhje me nenin 40 par. 1 nën-par. 5 dhe/ose nenit 40 par. 2 nën-par. 1 të KPPK/KPPK-së.

Pjesëmarrja e Gjyqtarit ndërkombëtar Guy Van Craen në kolegjin prej tre-gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 28 mars 2001, që ishte mbajtur mbi ankesën e Avokatit mbrojtës kundër urdhrit mbi paraburgimin (Hep. Nr. 47/2001) të lëshuar nga ana e Gjyqtarit hetues ndërkombëtar më 23 mars 2001 nuk përjashtoi Gjyqtarin nga ushtrimi i funksioneve juridike në lëndën e Florim Ejupit. Kjo i referohen veçanërisht faktit se më 12 mars 2009 Gjyqtari ka kryesuar kolegjin prej pesë-gjyqtarëve të



Gjykatës Supreme të Kosovës në shkallën e dytë për të vendosur mbi ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë mbi meritat e kësaj lënde (Ap.-Kz 409/2008).

aa. Lidhur me nenin 40, paragrafin 1, nënparagrafin 5 dhe nenin 40, paragrafin 2, nënparagrafin 1 të KPPK-së

Vendimi duhet të merret me pyetjen se si nenet 40, paragrafi 1, nënparagrafi 5 dhe neni 40, paragrafi 2, nënparagrafi 1 lidhen me njëri tjetrin, me cilat kushte dhe deri në cilën pikë gjyqtari do të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në një lëndë të caktuar.

Neni 40, paragrafi 1, nënparagrafi 5 i KPPK-së, siç i referohet lëndës në fjalë, parasheh si në vijim:

Gjyqtari ose gjyqtari laik përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur...në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët...

Neni 40, paragrafi 2, nënparagrafi 1 i KPPK-së, siç i referohet lëndës në fjalë, parasheh si në vijim:

Gjyqtari gjithashtu përjashtohet... Nga trupi gjykues kur për rastin e njëjtë penal... ai ose ajo ka marrë pjesë në procedurë paraprake, duke përfshirë edhe procedurën për konfirmimin e aktakuzës.

Edhe pse formulimi i nenit 40, paragrafi 1, nënparagrafi 5 i KPPK-së, nëse lexohet veçmas shpie deri te interpretimi gramatikor se në çdo rast gjyqtari i cili ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatë më të ulët në të njëjtën lëndë do të përjashtohet nga çfarëdo funksioni gjyqësor në të njëjtën lëndë, një krahasim me nenin 40, paragrafin 2, nënparagrafin 1 tregon se në lëndët diskutabile, dispozita e fundit është më specifike dhe prandaj mbizotëron.

bb. Në interpretimin e nenit 40, paragrafi 2, nënparagrafit 1 të KPPK-së

Mbi këtë historik, pyetja duhet të përgjigjet nëse neni nenit 40, paragrafi 2, nënparagrafi 1 i KPPK-së i referohet ndonjë akti gjyqësor gjatë procedurës paraprake në këtë mënyrë duke përjashtuar gjyqtarin nga udhëheqja e të gjitha procedurave derisa kjo lëndë të finalizohet, ose nëse përjashtimi i tij është i kufizuar vetëm në procedura e zhvilluar në shkallën e parë.

(1) Interpretimi gramatikor i ligjit është i hapur për pranim nga të dy drejtimet, pasi që ligji nuk përmend në mënyrë specifike ndonjë kufizim në faza të procedurës.

(2) Në aspektin sistematik vlen të përmendet se dispozitat e procedurës paraprake përfshirë edhe ato lidhur me konfirmimin e aktakuzës janë të koncentruara në Pjesën e Tretë (nenet 197 deri 318) të KPPK-së. Në anën tjetër, shumica e dispozitave mbi



çështjet e ankesave mund të gjenden në Pjesën e Pestë (nenet 389 deri 437) të KPPK-së, edhe pse e drejta në ankesë si e tillë, mirëpo pa ndonjë aktvendim mbi ndonjë çështje procedurale të detajuar gjithashtu pranohet nga disa dispozita nën Pjesën e Tretë të KPPK-së. Sidoqoftë, pozita e nenit 434 të KPPK-së nën Pjesën e Pestë të ligjit në fjalë, e cila vendos mbi kompetencat dhe përbërjen e organeve të ankesave, tregon se përjashtimi, rregullat e nenit 40, paragrafit 2, nënparagrafit 1 të KPPK-së nuk aplikohen në fazën e ankimit, mirëpo i referohen vetëm procedurës së shkallës së parë.

(3/4) Pasi që nuk ka qasje në asnjë dokument mbi **motivet e ligjit**, pyetja për **qëllimin e ligjit** mund të përdoret si mjet shtesë i interpretimit. Është mjaftë e qartë se qëllimi i nenit 40, paragrafit 2, nënparagrafit 1 të KPPK-së synon pranimin e të drejtës së individit për një gjykatë me gjyqtarë të paanshëm dhe në këtë mënyrë reflekton nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Mbi këtë historik, gjithashtu nuk është diskutabile se një gjyqtar i cili ka vepruar si gjyqtar i procedurës paraprake mund të mos jetë më i paanshëm në fazën e shqyrtimit gjyqësor në të njëjtën lëndë në shkallën e parë, ku ende dëshmitë do të duhet të mbledhen dhe vlerësohen. Në këtë kontekst, sidoqoftë duhet të njoftohet se faza e ankesës është e kualitetit të ndryshëm pasi që këtu fusha e shqyrtimit është e kufizuar në mënyrë strikte në ankesën e parashtruar. Prandaj, gjithashtu qëllimi i nenit 40, paragrafit 1, nënparagrafit 1 të KPPK-së tregon se gjyqtari i cili ka marrë pjesë në procedurën paraprake në një lëndë të caktuar nuk përjashtohet domosdoshmërisht në fazën e ankesës në të njëjtën lëndë vetëm për shkak të këtij fakti.

cc. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjE) mbi Përjashtimin e Gjyqarit

Edhe nëse **neni 40, paragrafi 2, nënparagrafi 1 i KPPK-së** do të ishte i aplikueshëm në të gjitha fazat e procedurës, në këtë mënyrë duke përjashtuar gjyqtarin nga e tërë procedura deri në finalizimin e lëndës, duhet të analizohet nën cilat kushte dhe deri në cilën pikë gjyqtari ka qenë i përfshirë në procedurën e mëhershme të lëndës në mënyrë që të konsiderohet si *“pjesëmarrës në procedurën paraprake”* siç kërkohet nga dispozita në fjalë e KPPK-së.

(1) Në disa raste GjE në baza të nenit 6 të KEDNj-së është dashur të merret posaçërisht me pyetjen se përfshirja e mëhershme e gjyqtarit në një lëndë të caktuar a e përjashton atë në fazë të mëvonshme në lëndën e njëjtë

Neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, të cilës i referohet GjE , përcakton si në vijim:

“Në përcaktimin e... çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë në shqyrtim...të... drejtë.. nga një...gjykatë e paanshme...”

(a) Në rastin e *Hauschildt kundër Danimarkës* (10486/83 [1989] ECHR 7, 24 maj 1989) Gjyqtari i njëjtë kishte vendosur për paraburgimin e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të shkallës së parë, në këtë mënyrë duke i marrë dëshmitë nga




dëshmitarët e shumtë dhe më në fund ka lëshuar aktgjykimin duke i shqiptuar të akuzuarit dënimin me shtatë vjet burgim. GjE ka pranuar vlerësimin e arsyeve për paraburgim dhe aktgjykimi i formës së prerë i nënshtrohet llojeve të ndryshme të vlerësimit. Për autorizimin e paraburgimit informatat nuk janë prezantuar në të njëjtën mënyrë si dëshmitë gjatë shqyrtimi pranë gjykatës. Procedura është e përmbledhur. Sipas GjE-së, posaçërisht vetë fakti se anëtari i gjykatës gjithashtu ka marrë pjesë si gjyqtar i vendimeve paraprake në lëndë në vetvete nuk e arsyeton frikën në paanshmërinë e tij apo saj. Normalisht, traditat e forta të gjyqësorit dhe aftësia e gjyqtarëve të cilat dalin nga arsimimi dhe trajnimi i tyre sigurojnë garanci të paanshmërisë efektive dhe të qartë të domosdoshme.

(b) Në rastin e *Padovani kundër Italisë* (13396/87 [1991], 26 shkurt 1993), GjE-ja ka mohuar paanshmërinë e Gjyqtarit dhe në këtë mënyrë shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së, edhe pse Gjyqtari kishte marrë në pyetje të pandehurin pas arrestimit të tij, ka konfirmuar arrestin, ka dëgjuar dy të akuzuar të tjerë, ka lëshuar urdhrin për arrest kundër të akuzuarve dhe ka iniciuar procedurën e menjëhershme kundër të akuzuarve, të cilën ai pastaj e ka zhvilluar. Për më tepër, i njëjti Gjyqtar pas marrjes në pyetje të bashkëpandehurve dhe dy dëshmitarëve ka shpallur të akuzuarin fajtor gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka shqiptuar dënimin ndaj tij i cili e ka tejkalluar propozimin e prokurorit. Në arsyetimin e saj, GjE-ja ka theksuar se masat e hetimeve të zhvilluara nga Gjyqtari janë përbërë “thjesht” me marrjen në pyetje e tre të akuzuarve edhe pse me nenin 231 të Kodit të Procedurës Penale të Italisë, Gjyqtari ka mundur të zhvilloj masa të mëtutjeshme. Për më tepër, në lëshimin e urdhrit për arrest Gjyqtari është mbështetur inter alias në deklaratën e të akuzuarit.

(c) Në rastin e *Tierce dhe të tjerëve kundër San Marinos* (24954/94; 24971/94; 24972/94 [1994], 25 korrik 2000), GjE-ja ka konsideruar se për shkak të rolit të dyfishtë të *Komisionarit të Ligjit* si Gjyqtar hetues dhe i gjykimit, i cili gjithashtu ka bërë përgatitjen e dosjes për fazën e ankesës në lëndën e njëjtë, *Komisionari (si Gjyqtari hetues)*, në veçanti brenda autorizimeve të tij në përgatitjen e dosjes mund të konsiderohet objektivisht si i paanshëm. Bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Italisë (nenet 174 deri 185), gjatë fazës së hetimeve të rastit, *Komisionari* ka ftuar dhe ka marrë në pyetje palët, ka lejuar kërkesa të mëtutjeshme për dëshmi, ka kërkuar mendimin e ekspertit dhe ka marrë në pyetje ekspertin si dhe dëshmitarët e mbrojtjes. Pastaj i njëjti *Komisionar* ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në shkallën e parë, në këtë mënyrë duke marrë dëshmitë nga palët si dhe nga dëshmitarët e ndryshëm të mbrojtjes dhe përfundimisht ka sjellë aktgjykimin.

Bazuar në aktgjykimet e lartpërmendura duhet të përfundohet se GjE-ja nuk i përmbahet idesë për përjashtimin automatik të gjyqtarit, mirëpo favorizon vlerësimin e lëndëve veç e veç të secilit veprim specifik të gjyqtarit gjatë fazave të ndryshme të lëndës së caktuar. Në veçanti, GjE-ja rithekson se për qëllimet e nenit 6, paragrafit 1 të KEDNj-së, paanshmëria e gjykatës duhet të vlerësohet me mjetet e testit subjektiv, i cili konsiston në kërkimin e përcaktimit të bindjes personale të një gjyqtari në lëndën e caktuar, dhe me mjetet e testit objektiv, i cili konsiston në vërtetimin se a ka ofruar gjyqtari garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim lidhur me këtë




(shih aktgjykimin në rastin Padovani kundër Italisë (më lart), faqe 20, § 25 dhe *Tierce dhe të tjerët kundër San Marinos*, faqe 12 § 75 (më lart)).

(2) Mbi këtë historik, **në këtë lëndë** pyetja e përjashtimit të mundshëm të gjyqtarit përkatës Guy Van Craen, **nën aspektin subjektiv** kërkon përqendrim në pyetjen se a ka apo jo ndonjë përcaktim të bindjes paraprake të gjyqtarit që mund të bazohet në përfshirjen e tij fazën e procedurës paraprake të lëndës. **Nën aspektin objektiv**, në njërën anë, duhet të përqendrohet në kohën kur gjyqtari ka qenë i përfshirë në fazën e procedurës paraprake të lëndës, dhe në anën tjetër, në kualitetin e masave specifike, të përmbushura nga kolegji në fjalë.

(a) Nuk ka shenja paralajmëruese që të merren parasysh se gjyqtari kur ka qenë kryetar i kolegjit për ankesa, subjektivisht tanimë ka pasur bindje paraprake mbi lëndën, bazuar në përfshirjen e tij në procedurën paraprake.

(b) **Sa i përket kohës** duhet të merret parasysh se gjyqtari i është bashkangjitur kolegjit prej tre anëtarësh të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i cili është dashur të vendos mbi nakesat e Avokatit mbrojtës kundër caktimit të paraburgimit nga gjyqtari hetues dhe prandaj është mbledhur më 28 mars 2001 duke lëshuar vendimin në fjalë. Veprimet dhe vendimi i gjyqtarit janë bazuar në nenin 191, paragrafin 2, pikët 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit mbi Procedurën Penale (LPP-së) të RSFJ-së, i cili në atë kohë ka qenë në fuqi. Kjo është **arsyeja formale** pse gjyqtari, edhe pse ai më vonë, në vitin 2009, ka qenë kryetar i kolegjit për ankesa të gjykatës së shkallës së dytë, nuk i ka ushtruar funksionet e gjyqtarit të procedurës paraprake, siç kërkohet me nenin 40, paragrafin 2, nënparagrafi 1 i KPPK-së.

(c) Gjithashtu **kualiteti material i vendimit të procedurës paraprake të datës 28 mars 2001** nuk ofron argumente të mjaftueshme për përjashtimin e gjyqtarit në fazën e mëvonshme të procedurës. Kolegji në fjalë është kujdesur për çështjet e sigurisë, në këtë mënyrë duke vlerësuar kushtet për paraburgim siç përcaktohet me nenin 191, paragrafin 2, pikët 1, 2, 3 dhe 4 të LPP-së. Kolegji ka konstatuar se nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme për pjesëmarrjen në këtë krim të tre të dyshuarve tjerë dhe prandaj i kanë liruar ata. Sa i përket të pandehurit Florim Ejupit, kolegji ka konfirmuar se ekziston dyshimi i bazuar siç kërkohet për paraburgim, pasi që shkresat e lëndës kanë siguruar analizat e ADN-së të gjurmëve të gjetura në një cigare pirë, e cila është gjetur në vendin nga ku pretendohet të jetë aktivizuar bomba dhe është përputhur me mostrën e marrë më parë nga i pandehuri Florim Ejupi nga Policia e Gjermanisë, i cili në atë kontekst ishte akuzuar për grabitje të rëndë, vrasje në tentativë dhe krime të tjera. Duke e pas parasysh këtë bëhet e qartë se kolegji i procedurës paraprake në fjalë dhe gjyqtari përkatës si anëtar i kolegjit nuk ka shkuar fare në meritat e lëndës, por ka vlerësuar vetëm kushtet për paraburgim. Mbi historikun e arsyeve të lartpërmendura dhe përkundër pyetjes se a është i aplikueshëm neni 40, paragrafi 2, nënparagrafi 1 i KPPK-së edhe në fazën e ankimit të lëndës; nuk mund të vërtetohet asnjë pretendim i bazuar se gjyqtari përkatës në fazën e ankimit në lëndë është përjashtuar në të vërtetë për shkak se ka marrë pjesë



në procedurën paraprake, siç përcaktohet me nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafin 1 të KPPK-së.

b. Shkeljet e pretenduara të nenit 403, paragrafir 2, nënparagrafit 1 lidhur me nenin 157, paragrafin 1 të KPPK-së

Interpretimi i gabuar i statusit të “dëshmitarit Alfa” nga kolegji i ankesave është vërtetuar si në vijim:

Kolegji për ankesa – pa arsytim të mëtutjeshëm – ka konsideruar “dëshmitarin Alfa” si dëshmitar anonim, duke iu referuar nenit 157 të KPPK-së në mënyrë që të përfundohet se “... në cilindo rast aktgjykimi nuk mund të bazohet, vetëm, në deklaratën e një dëshmitari anonim”.

Duhet të nënvizohet se “dëshmitari Alfa”, duke qenë dëshmitarë i prokurorisë, nuk ka qenë dëshmitar anonim deri më tani në kuptimin e nenit relevant neni 172, paragrafi 1 i KPPK-së.


Neni 172, paragrafi 1 i KPPK-së përcakton si në vijim:

Kur masat mbrojtëse të parapara në neni 170, paragrafi 1 i këtij Kodi janë të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e...(a) dëshmitari i cili nuk është propozuar nga mbrojtja, gjyqtari në rrethana të jashtëzakonshme mund të marrë urdhër për anonimitet me të cilin...dëshmitari mbetet anonim për të pandehurin dhe mbrojtësin.

Ky nuk ka qenë rasti sa i përket “dëshmitarit Alfa”, pasi që nuk janë përmbushur asnjëri prej kushteve të përcaktuara me nenin 172, paragrafin 1 të KPPK-së.

Kërkesa e Prokurorit ndërkombëtar për anonimitet lidhur me këtë dëshmitarë, e datës 1 dhjetor 2004, është refuzuar nga Gjyqtari ndërkombëtar me vendimin e datës 6 dhjetor 2004. Gjyqtari i referohet Rregullores së UNMIK-ut 2001/21 “Mbi Dëshmitarët Bashkëpunues”, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/02 në nenet 2.4, 3.1, 3.3 dhe 4.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/20 “Për Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe të Dëshmitarëve në Procedurën Penale” i ka dhënë statusin e “dëshmitarit Alfa” si dëshmitar bashkëpunues, mirëpo ka konstatuar se kushtet për anonimitet nuk janë përmbushur, kurse kriteret për masat mbrojtëse janë përmbushur.

Më 11 maj 2006, Prokurori ndërkombëtar ka paraqitur propozimin për masa të reja mbrojtëse përfshirë edhe caktimin e pseudonimit për dëshmitarin. Bazuar në këtë propozim, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, më 11 maj 2006 ka vendosur që dëshmitarit do ti referohen si “dëshmitari Alfa” dhe ka lëshuar urdhrin për masat mbrojtëse sipas nenit 170, paragrafit 2 të KPPK-së.



Prandaj, “dëshmitari Alfa” drejtësisht është dashur të konsiderohet si i mbrojtur por jo dëshmitar anonim, duke i dhënë kolegjit për ankesa mundësinë që ti jep rëndësi më të madhe deklaratës së tij/saj në kontekstin se është vërtetuar me dëshmi tjera, posaçërisht me ekspertizën e ADN-së.

c. Ndikimi faktik i statusit të “dëshmitarit Alfa” në vendimin material të lëndës


Prokurori Publik Ndërkombëtar i ZPSK-së në Kërkesën e saj për Mbrojtjen e Ligjshmërisë ka theksuar në kontekst të statusit të përcaktuar drejt të “dëshmitarit Alfa” si dëshmitar i mbrojtur që në këtë lëndë kolegji i apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës mund të ketë sjell vendim tjetër dhe jo të liroj të pandehurin Florim Ejupi, pasi që deklaratat e dëshmitarit është vërtetuar me dëshmi tjera, posaçërisht me analizën e ADN-së në bishtin e cigares e gjetur në vendngjarje menjëherë pas shpërthimit. Edhe pse, sipas nenit 415 paragrafi 1 KPPK-së është e obligueshme për kolegjin e Gjykatës Supreme në kontekst të Kërkesës së Mbrojtjes së Ligjshmërisë ti ekzaminoj sipas detyrës zyrtare vetëm çështjet të përmendura nën pikat 1 deri në 4, ndërsa për të tjerat gjykata është e lidhur me temat e sfiduara prej kërkesës, e konsideron të duhur në lëndën afër për të kontrolluar nëse kolegji i shkallës së dytë e ka vlerësuar dëshminë në mënyrë të duhur, duke arritur rezultatin e formuluar në diapozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

aa.

Kolegji i apelit, duke e marr parasysh që sipas nenit 387 paragrafi 1 i KPPK-së aktgjykimi mund vetëm të bazohet në dëshmitë të konsideruara në shqyrtimin kryesorë, ka hartuar konkluzën që nuk ka dëshmi të drejtpërdrejtë të prezencës së të pandehurit në vendngjarje derisa ai ishte duke u përgatitur apo ekzekutuar krimet me të cilat ai është dënuar. Bazuar në këtë pyetje shtrohet pyetja **nëse kolegji detyrimisht do të mund të sillte vendim tjetër apo jo** dhe posaçërisht mos ta kishte liruar të pandehurin Florim Ejupi, nëse “dëshmitari Alfa” drejt të ishte konsideruar si dëshmitar i mbrojtur sipas nenit 170 paragrafi 1 pika 4 e KPPK-së në vend të dëshmitarit anonim sipas nenit 172 paragrafi 1 i KPPK-së.

(1) Besueshmëria e deklaratave të “dëshmitarit Alfa”

Kolegji i apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës ka ardhur te bindja se besueshmëria e deklaratave të “dëshmitarit Alfa” është diskutabile prandaj nuk mund të jetë provë e mjaftueshme për pjesëmarrjen e të pandehurit në sulmin me bombë në autobus. Sa i përket bazës së kësaj bindjeje, kolegji ka vërejtur se dëshmitari ishte i përgatitur dhe këshilluar prej policëve hetues me qëllim të infiltrimit të grupit të pandehurit në burgun e Dubravës, por këto kurrë nuk janë urdhëruar apo kontrolluar prej gjyqtarit të procedurës paraprake. Gjithashtu, duhet të merret parasysh se dëshmitari për bashkëpunimin e tij ka pranuar premtime dhe përfitime. Gjithashtu, dyshimet e kolegjit që kanë të bëjnë me besueshmërinë e dëshmitarit janë përforcuar me faktin se deklaratat e dëshmitarit në shumë raste dallojnë prej njëra tjetra sa i përket kohës së referuar, formulimi i bisedave me të pandehurin dhe hollësitat tjera, edhe pse ishin të lidhura me situatat e njëjta dhe se ato nuk përputheshin me deklaratat e dëshmitarëve tjerë që i përkasin çështjeve të njëjta. **Gjithashtu**



personaliteti i dëshmitarit nuk e fton gjykatën t'i besoj atij pa provat përkrahëse konsekuente të mëtutjeshme, pasi që dëshmitari më parë ishte i përfshirë në çështjet penale, tentimet e arratisë dhe masat disiplinore në burg.

Gjykata Supreme e Kosovës në kontekst të Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë gjen se ka shumë kontradikta në mes të deklaratave të ndryshme të dhëna prej “dëshmitarit Alfa” në disa raste. Veç kësaj, deklaratat e “dëshmitarit Alfa” nuk përputhen me deklaratat e dëshmitarëve tjerë, të cilat janë të lidhure me tema të njëjta.

Nuk është as e mundur apo e nevojshme të shkohet nëpër të gjitha- edhe pse të pakta- kontradiktat në deklaratat e dëshmitarit. Megjithatë, mund të lexohet prej procesverbalit të shqyrtimit kryesorë të shkallës së parë i datës 25 janar 2008 (f. 6 e versionit në Gjuhën Angleze) dhe e 10 prillit 2008 (f. 6 të versionit në Gjuhën Angleze) se dëshmitarët u deklaruan ndryshe në pyetje, kur dhe ku ai e takoi për herë të parë të pandehurin Florim Ejupi, domethënë nëse kjo ishte me 17 mars 2004 në lagjet e Mitrovicës apo në shtëpinë e dajës/axhës së tij. Gjithashtu, sipas procesverbalit të shqyrtimit kryesorë të datës 25 janar 2008 (f. 12 të versionit të Gjuhës Angleze) dhe 10 prill 2008 (f. 7 e versionit të Gjuhës Angleze), dëshmitari ka deklaruar se ai në burgun e Dubravës ka lidhur bisedë me të pandehurin lidhur me shpërthimin me bombë të autobusit të Nishit në artikullin e gazetës serbe, e publikuar në gazetën “Blic” dhe se artikulli në atë kohë i është dorëzuar atij prej zyrtarit korrektues, menjëherë pas publikimit të tij. Kjo ka qenë në vitin 2005. Edhe pse dëshmitari ka identifikuar artikullin që i është treguar atij gjatë shqyrtimit kryesorë dhe se ishte i informuar lidhur me faktin që ishte i publikuar me 9 qershor 2004, dëshmitari insistoi në deklaratën e tij të mëparshme. Përfundimisht, dëshmitari në të dyja rastet ka deklaruar se i pandehuri Florim Ejupi i ka thënë atij se ka qenë një person i quajtur “Alban”, i cili ka shtënë me Zolë apo granatë të mortajës së dorës nga prapa në autobus pasi që veç kishte shpërthyer (procesverbali i shqyrtimit kryesorë i datës 25 janar 2008, f. 18 të versionit të Gjuhës Angleze dhe 10 prill 2008, f. 21 dhe 22 të versionit të Gjuhës Angleze). Përkundër faktit që dëshmitari nuk ka bërë dallim në mes të dy llojeve të sipërpërmendura të armëve, ishte vetëm ai që dha deklaratë të tillë. Asnjë provë që përputhet për përdorimin e njërës prej armëve të përmendura nuk është gjetur, as në vendngjarje e as përmes ndonjë dëshmitari.

Posaçërisht duke i referuar pyetjes se si ka shpërthyer bomba, deklarata e dëshmitarit dallonte seriozisht prej mendimit dhe deklaratës së ekspertit, e dhënë prej dëshmitarit ekspert Andrija Blazević sipas procesverbalit të shqyrtimit kryesorë të datës 13 maj 2008. Përderisa “dëshmitari Alfa”, duke referuar kështu për bisedën me të pandehurin Florim Ejupi deklaroi se me 10 prill 2008 (f. 10 e versionit të Gjuhës Angleze) që sipas të pandehurit bomba ka shpërthyer me ndihmën e baterisë së veturës si mjet shpërthyes, dëshmitari ekspert për lëndët plasëse deklaroi para kolegjit të shkallës së parë se bateria e veturës kurrë nuk do të ishte e mjaftueshme të shpërthej atë bombë. Eksperti ka marr në konsideratë rezistencën fizike të kapsulës së veçantë elektro-plasëse e gjithashtu edhe prej kabllave dhe ka gjetur se plasësi i mjaftueshëm do të duhej të kishte fuqi minimale prej 2 amperëve (94.4 volt), përderisa **bateria e**



zakonshme e veturës ka vetëm 12 volt dhe bile bateria e kamionit siguron jo më tepër se 24 volt. Në këtë kontekst është e rëndësishme që të dy dëshmitarët, Antony James Davies dhe Darrell Guy Hodder, kështu që duke qenë policë hetues të vendngjarjes, me kërkesën e kolegjit të shkallës së parë ka dhënë mendim se bateria e veturës do të mjaftonte të shpërthej një bombë si ajo e shpërthimit të bombës së autobusit të Nishit. Megjithatë, duhet të nënvizohet se të dy dëshmitarët e sipërpërmendur gjithashtu kanë deklaruar se ata nuk kanë përvojë të mjaftueshme për lëndët plasëse dhe nuk mund të konsiderohen si ekspertë në këtë fushë.


Prandaj, Gjykata Supreme duke konsideruar kornizat e pavarësisë gjyqësore gjatë vlerësimit të provave të ofruara gjykatës gjen që kolegji i apelit nuk ishte i obliguar të ndjek deklaratat kontradiktore në shkallë të gjerë të “dëshmitarit Alfa”.

(2) Mbi vlerësimin e provave të mbështetura

Veç kësaj duhet të theksohet që **kolegji i apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës** pavarësisht prej vlerësimit të besueshmërisë dhe të konsiderimit të mëtutjeshëm të “dëshmitarit Alfa” si dëshmitar i kontrollit të duhur dhe i besueshëm ka shprehur dyshime serioze në lidhje me kualitetin e analizave të ADN-së së bishtit të cigares së gjetur në vendngjarje si provë me vlerë. Bishti i cigares ishte konsideruar si prova më e rëndësishme mbështetëse e lëndës prej gjykatës së shkallës së parë. Mund të lexohet prej arsytimit të aktgjykimit të shkallës së dytë që nuk ishte e mundur që të konstatohet qartë, kur është pirë cigarja, posaçërisht nëse është pirë para apo pas shpërthimit. Përkundër këtij fakti, kolegji i apelit ka nënvizuar që dosja nuk ka përmbajtur prova të mjaftueshme për identitetin e bishtit të cigares të gjetur në vendngjarje dhe të asaj që ishte test krahasues me mostrën e ADN-së së të pandehurit Florim Ejupi e mbajtur në Gjermani. Vendimi i ankesës së GJSK-së i datës 12 mars 2009 në këtë kontekst posaçërisht thekson se *“për më tepër, nuk ka provë të mjaftueshme që me të vërtetë bishti i cigares së gjetur në vendngjarje është bishti i cigares së njëjtë (asnjë raport hetues për gjetjen, mbylljen dhe ose shënjimin e provës) e cila ishte subjekt i testit krahasues me mostrën e ADN-së e cila është mbajtur në Gjermani (testi i mëparshëm i ADN-së i marr në lëndën tjetër penale prej të akuzuarit)”*.

Gjykata Supreme e Kosovës duke konsideruar kështu Kërkesën e Mbrojtjes së Ligjshmërisë ka rishikuar të gjitha dokumentet relevante të siguruara në shkresat e lëndës e gjithashtu edhe analizat e ekspertit të ADN-së së Bundeskriminalamt gjerman (Instituti për Shkencat Mjeko-ligjore) i datës 5 mars 2001, i cili gjithashtu është pjesë e shkresave të lëndës.

Si rezultat është e nevojshme të konstatohet që pyetja, nëse lista e artikujve të konfiskuar në mes të bishtave të cigares të gjetura në vendngjarje me 16 shkurt 2001 dhe të atyre të që janë duke u analizuar për gjurmë të ADN-së në Bundeskriminalamt në Gjermani me 5 mars 2001 është mbyllur, në një shkallë të gjerë bie nën kërkesat e vendosura individualisht prej gjykatësit përgjegjës pra, duhet të shihen nën aspektin e pavarësisë gjyqësore.



Shkresat e lëndës përmbajnë shtatë dokumente relevante, të cilat i referojnë provave të përmendura.

Përshkrimi i vendngjarjes së të gjeturave me 16 shkurt 2001, të datës 4 mars 2001 me skicën e bashkangjitur të vendngjarjes veçse shënon gjetjen e *“bishtit të cigares dhe gypit kontrollues”* në pikën pretenduese të qitjes, por prapë pa e shënuar provën si AJD/1, siç mund të gjendet më vonë në dokumente. Dokumenti në këtë kontekst vetëm tregon se policët hetues të UNMIK-ut *“bënë matjet e provave fizike të bazuar në vendet e tyre përkatëse dhe i mblodhën dhe i paketuan ato në pajtim me specifikat e tyre me etiketat/numrat që korrespondojnë”*.

Dokumenti më i hershëm që i referon numrit të etiketës i dhënë vetë bishtit të cigares është deklarata e dëshmitarit policit hetues të UNMIK-ut Anthony James Davies, i datës 20 shkurt 2001. Dëshmitari deklaroi se *“artikujt vijues më pas janë mbyllur në qese të provave dhe janë shënuar siç tregohen; ... AJD/1 – 1 x bisht i cigares + gypi kontrollues (vendi i gjetjes: i ngulitur në trungun e drurit në pikën e dukshme të qitjes (a)). ... Unë i kam shënuar etiketat. ... Unë i mbajta provat AJD/1 ... në posedimin tim deri të shtunën, 17shkurt 01, kur i kam dorëzuar ato së bashku me filmin e ekspozuar në Njësinë e Mjekësisë-ligjore, Skuadra Regjionale për Krime, Policia Civile e UNMIK-ut, Prishtinë”*.


Prej urdhrit të UNMIK-ut për ekzaminim (analiza) në Njësinë e Laboratorit të Krimeve të datës 23 shkurt 2001 mund të lexohet se së bashku dy bishta të cigares janë gjetur në vendndodhje, prej të cilave njëra është shënuar si *“AJD/1 bisht cigareje dhe gyp kontrolli”*, përderisa tjetra është shënuar si *“AQC bisht cigareje”*.

Pastaj mund të lexohet prej ekspertizës gjermane të ADN-së së Bundeskriminalamt Wiesbaden të datës 05 mars 2001 (dosja numër KT 31 – 01/1131/002), e cila i referohet *“sulmit me bombë mbi autobusin serb me 16 shkurt 2001 në Podujevë”* si temë dhe me *“kërkesën e UNMIK-ut për ekzaminim, Njësia Hetuese RMS Prishtinë, lënda # 01/011 e datës 23 shkurt 2001”* që dy *“trungjet”* kanë qenë të dërguar dhe janë analizuar, prej të cilave njëra prej tyre (e shënuar si AJD/1) ka pasur profilin e ADN-së të Florim Ejupit. Mendimi i ekspertit në këtë kontekst thotë se *“sipas kërkesës ne kemi dy trungje me numra të provave AJD/1 dhe AQC/7...”*. Mostra korresponduese e ADN-së në Gjermani ishte marrë, pasi që i dyshimti më parë ishte nën hetim dhe ose i akuzuar në Gjermani për tentim vrasje, vjedhje me thyerje, tentim vjedhje me thyerje, vjedhje e kryer në bashkëpunim me bashkëkryerës tjerë, vrasje e rëndë dhe shkelje e Ligjit mbi Narkotikët dhe vepra tjera penale.

Sipas dokumentit dorëzues të Bundeskriminalamt Wiesbaden të datës 23 maj 2003, *“... Pjesa tjetër e cigares dhe pajisja e zbrazët krahasuese ...”* me etiketën AJD/1 i është kthyer mbrapa UNMIK-ut.

Bazuar në rezultatet e mësipërme të analizave të ADN-së, Përmbledhja e lëndës së UNMIK-ut e datës 26 mars 2001 dhe e dërguar tek Prokurori Ndërkombëtar referohet si *“... Prova të mbledhura prej ngjarjes duke përfshirë bishtin e cigares të gjetur në trungun e drurit në vendin e qitjes ...”*

Dhe Raporti Hetues i datës 12 prill 2005 referohet si *“... ky bisht i cigares (AJD-1) ... i analizuar dhe ADN-ja e Florim Ejupit ... e gjetur (dosja C faqe 70 dhe 71)”*



Edhe pse kjo listë e artikujve të konfiskuar mund të shpie në konkluzionin se kjo listë e artikujve të konfiskuar në mes të bishtit të cigares së gjetur në vendngjarje dhe të asaj që është duke u analizuar në Gjermani për gjurmë të ADN-së është e mbyllur, nevojitet të mbetet me gjyqtarin përgjegjës, kështu që duke e formuar kolegjin e apelit të kërkoj gjithashtu raport të hetimeve mbi gjetjet, mbylljen dhe/apo shënimin e provave, të cilat me të vërtetë nuk përfshihet në këto shkresa të lëndës. Vetëm një raport i tillë, i cili gjithashtu është pjesë e Standardeve Evropiane, përfundimisht mund të siguroj që dëshmitë e gjetura në vendngjarje janë në të vërtetë identike me dëshmitë e paraqitura në gjykatat dhe gjatë hetimeve. Së paku, në mes të gjetjes së bishtit të cigares me 16 shkurt 2001 në vendngjarje dhe të përmendjes së parë me etiketë prej dëshmitarit, policit Anthony James Davies me 20 shkurt 2001 në deklaratën e tij dëshmuese, është një zbrazëtirë prej afër katër ditësh, brenda të cilës vendndodhja e bishtit të cigares nuk mund të konstatohet pa asnjë dyshim. Prandaj, kolegji i shkallës së dytë ishte i lirë, por nuk ishte i obliguar të pranoj listën e artikujve të konfiskuar që të jetë e mbyllur siç është përmendur më lart.

Veç kësaj, është e rëndësishme në këtë kontekst që sipas mendimit të ekspertit të Bundeskriminalamt në Wiesbaden të datës 5 mars 2001; dy bishta të cigares janë dërguar dhe ekzaminuar për gjurmë të ADN-së. Njëra prej tyre e shënuar si AJD/1 është gjetur në pikën e pretenduar të qitjes dhe ka pas gjurmë të ADN-së të pandehurit Florim Ejupi. Tjetra ishte shënuar si AQC/7. Nuk është aq e qartë prej shkresave të lëndës ku dhe në çfarë rrethana ky bisht i cigares ishte gjetur. Vetëm mund të konkludohet prej indeksit të provave, i ruajtur prej NJQHK Njësia e krimeve të luftës së UNMIK-ut që ky bisht i cigares ishte gjetur me 20 shkurt 2001 gjatë kontrollimit të veturës VË Golf të ngjyrës së kuqe, e cila ishte e regjistruar në emër të Fadil Selmanit me tabela 107-KS-798. Gjithashtu, është përmendur në Urdhrin e UNMIK-ut për Ekzaminim (Analiza) në Njësinë e Laboratorëve të Krimit të datës 23 shkurt 2001. Asnjë informatë tjetër lidhur me këtë bisht cigare nuk mund të gjendet në shkresat e lëndës. Gjithashtu, prej këtyre rrethanave dyshimet e kolegjit të ankesave në lidhje me listën e mbyllur të artikujve të konfiskuar në lidhje me provat mbështetëse konsiderohen të arsyeshme.

Gjatë ekzaminimit të provave relevante të shkresave të lëndës, **Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu ka gjetur** që në të vërtetë nuk ishte e mundur për kolegjin e shkallës së parë të përcaktoj kohën e saktë se kur ishte konsumuar bishti i cigares që është gjetur në vendngjarje. Dëshmitarët Anthony James Davies dhe Darrell Guy Hodder, të cilët në funksionet e tyre si policë hetues kanë gjetur bishtin e cigares, gjatë seancës së shqyrtimit kryesorë me 17 prill 2008 kanë deklaruar shumë përgjithësisht në pyetjet relevante të kolegjit të shkallës së parë. Dëshmitari Antony James Davies deklaroi se bishti i cigares “ ... nuk ishte i thatë, për të sugjeruar se ka qenë atje për një kohë apo disa ditë ... ” dhe gjithashtu “ ... nuk ishte i lagur apo i njomë për të sugjeruar se ka qenë i konsumuar kohët e fundit ” (procesverbali i shqyrtimit kryesorë, f. 10 i versionit të gj. angleze). Dëshmitari Darrell Guy Hodder ka shpjeguar paraqitjen e bishtit të cigares si “freskët”, domethënë që “ ... nuk kishte ndryshim të ngjyrës në bishtin e cigares ”, siç “ ... do të ndodhte nëse do të ishte në



kohën me shi dhe diell”. Prandaj, kolegji i Gjykatës Supreme gjen se kjo në të vërtetë nuk lejon përcaktim nëse cigarja është konsumuar drejtpërdrejtë para shpërthimit, disa orë më herët apo pak më vonë.

bb.

Si pasojë, duhet të konstatohet që kolegji i ankesave – edhe nëse statusi i “dëshmitarit Alfa” në mënyrë të duhur është konsideruar si një prej të mbrojturve në vend të dëshmitarit anonim – nuk ka qenë i obliguar të gjej aktgjykim tjetër prej atij që është paraqitur në diapozitiv dhe gjithashtu sigurisht nuk ka mundur të kapërcej dyshimet e tija serioze lidhur me vlerën e provave tjera, posaçërisht analizave të ADN-së. Pra, gjithashtu konsideratë e drejtë për “dëshmitarin Alfa” si dëshmitar të mbrojtur gjoja se nuk do ta shpinte kolegjin e ankesave në vendim tjetër, posaçërisht duke e konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë në përcaktimet substanciale.

III. Konkludimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Prej arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës konkludon se Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është e pabazuar prandaj refuzohet.

Përfundimisht dhe duke e pasur në mendje seriozitetin e krimit të kryer mund të ngritët pyetja nëse kolegji i ankesave si rezultat i konkluzave të veta ishte i obliguar të gjej vendim tjetër prej diapozitivit në fjalë, posaçërisht të prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta kthej lëndën për rigjykim në vend të modifikimit të menjëhershëm të aktgjyimit me përmbajtje të lirimit të pandehurit nga të gjitha akuzat.


Megjithatë, kolegji i ankesave në aplikimin e nenit 406 paragrafi 1 nëpërmes nenit 426 të KPPK-së nuk e ka kthyer për rigjykim, pasi që është gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka përcaktuar faktet materiale në mënyrë të duhur por ne lidhje me përcaktimin e situatës faktike, posaçërisht mungesës së provës bindëse kundër të pandehurit, do të duhej të lejohej në vend të kësaj aktgjykimi i lirimit. Kështu, në sfondin e bindjes së tij, kolegji i ankesave drejtësisht i referohet situatës së adresuar me nenin 426 paragrafi 1 të KPPK-së.

Si pasojë e kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendos në Kërkesën ZPSK mbi Mbrojtjen e Ligjshmërisë si në dispozitiv, bazuar në nenin 456 të KPPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Pkl-Kzz 71/09, 10 nëntor 2009

Anëtar i kolegjit

Miftar Jasiqi



Anëtar i kolegjit

Osman Tmava

Anëtar i kolegjit

Zait Xhemajli

Prosesmbajtës

Mejreme Memaj

Edita Kusari

Anëtar i kolegjit



Kryetari i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger